



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MIRDITË

DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE MARRËDHËNIEVE ME QYTETARËT

Rrëshen më __.__.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - SHËRBIM

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Kaçinar, Bashkia Mirditë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
- 77200000-2 (Sherbimet pyjore)

VLERA E FONDIT LIMIT: 12 616 500 (Dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë pa Tvsh,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentim: Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një vit, për vitin e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës konkretisht **12 616 500** (Dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare, (Vitin e fondit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar shprehimisht se : 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar

në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës dhe **faturen tatimore** të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit ***në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4.. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet

të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

AK ka sigurinë dhe besueshmerinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencën dhe është vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar duke filluar nga 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, *minimumi 12 (dymbëdhjetë) punonjës* ku në përzierje të numrit të punonjësve në listat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të jenë të paktën 6 (gjashtë) inxhinierë pyjesh duke përfshirë drejtuesin teknik. Kjo kërkesë është e rëndësishme për krijimin e grupeve të punës të paktën 2-3 grupe pune për nga 3 specialistë si dhe ekspertët e tjerë do të kryejnë punime zyrtare. Këto punonjës duhet të vërtetohen me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimum për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listat e pagesave përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimum për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listat e pagesave përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

2.3.3 - Operatorët ekonomikë pjesëmarrës bazuar në volumin e punës në këtë ekonomi pyjore në largësi nga rruga nacionale, kompleksitetin në kryerjen e këtij shërbimi, rëndësinë dhe pjekurinë profesionale, duhet të kenë të punësuar si staf teknik kryesor brenda numrit total të punësuar sipas pikës 2.3.2 kjo e përcaktuar dhe në manualin e planeve të mbareshtimit që kërkohet që një grup pune të ketë në përzierje të tij 3 specialistë pyjesh, specialistë të profileve me eksperiencë pune në fushat respektive, si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për 3 muajt e fundit, në profesionet si më poshtë:

- **Drejtuesi teknik 1 (një) inxhinier pyjesh** i regjistruar në listat që nga fillimi i vitit 2025 e në vazhdim i reflektuar në ekstraktin e kompanisë si drejtues teknik dhe i regjistruar në QKB si drejtues teknik (për të realizuar një planifikim shumë – funksional, për hartimin e metodikës, organizimin e stafit, planin e veprimit, grafikun e realizimit punimeve, mbrojtjen e studimit, si drejtues i grupit të punës)

-4 (kater) Specialiste Pyjesh (Inxhinier), të cilët do të jene pjese e grupeve te terrenit për ekonominë pyjore në studim (Stafit teknik) me përvojë në fushën e pyjeve dhe kullotave, Hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimit të tyre të qëndrueshëm, aspekteve Silvo-pastorale, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, të ketë aftësi të mira organizative në grup etj. Përdor mirë teknologjinë në marrjen e të dhënave të terrenit dhe regjistrimin online të tyre, sipas programeve të miratuara. Kjo kerkese eshte e parashikuar ne *"Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 per grupet e terrenit sipas pikes D, D.1.1."***Perberja e ekipit te punes**" secili nga ekipet e punes se terrenit duhet të përbëhet nga 2 specialiste profesionale (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert ne punen e terrenit).

-1 (një) Specialist GIS, per ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, përgatitjen e hartave të ndryshme sipas termave të referencës (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj), përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale (Inxhinier topograf/gjeodet/), i ***pajisur me Liçencë në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, nga autoritetet kompetente ligjore, ne listpagesa per tre mujorin fundit te deklaruar.***

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit teknik/ekspertëve kryesorë që do të angazhohen në kryerjen e këtij studimi, do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me dokumentat e mëposhtme:

- Per inxhinierat e pyjeve perfshire dhe drejtuesin teknik duhet te paraqesin dokumentat si me poshte:

- 1) *Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)*
- 2) *Diplomë universitare.*
- 3) *CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime.*
- 4) *Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar*
- 5) *Per drejtuesin teknik listpagesat nga fillimi i vitit 2025 dhe ekstraktin e kompanise qe te jete i regjistruar ne ekstrakt si drejtues teknik.*

- Per inxhinierit Gjeodet duhet te paraqesin dokumentat si me poshte:

- 1) *Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)*
- 2) *Diplomë*
- 3) *Licence në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, leshuar nga autoritetet kompetente ligjore.*
- 3) *CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime*
- 4) *Listpagesat per tre muajt e fundit te deklaruar*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton numrin e punonjësve dhe, do të dorëzohet nga ofertuesi i

kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit v-Operatori duhet të percaktoje me ane të nje deklarate nga Administratori i Shoqerise, *Drejtuesin Teknik*, i cili duhet të jete i punesuar sipas listpagesa, i profesionit Inxhinier Pyjesh, per te cilin duhet te paraqese:

Drejtuesi teknik duhet të paraqes dokumentat: Diploma, Kontrate pune si drejtues teknik, Lejen Profesionale të ushtrimit të profesionit për 4 kategorite, dhe të figurojë në list pagesat e shoqërisë që nga fillimi i vitit 2025 (janar e në vazhdim) si dhe të jete i pasqyruar ne Ekstraktin e shoqerise si drejtues Teknik i kompanise i regjistruar ne QKB.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme në pikat 2.3.2, 2.3.3 është përcaktuar në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet shprehimisht se: 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe , në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, duke marrë në konsideratë se objekti ka një sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve e kullotave ,si dhe kohezgjatja e kontrates që është për një afat kohor 9 muaj .Për realizimin e kontrates duhen të paktën 2 grupe pune në terren . Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet shprehimisht: 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Kërkesa për Inxhinieri gjeodet është e nevojshme për arsye se inxhinieri gjeodet do të merret me përgatitjen e hartave pyjore sipas Manualit të planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3.4 Staf teknik mbështetes.

Inxhinier pyjesh ose teknik 2(dy), me pervojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit, referuar Udhëzuesit të PM *me Nr.864 prot., datë 30.01.2019* ku “Secili nga ekipet e punes se terrenit duhet te perbehet nga 2 specialiste profesioniste (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert ne punen e terrenit)”, duke paraqitur dokumentat si me poshte:

- 1) *Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit te kontrates)*
- 2) *Diplomë*
- 3) *CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime.*

Kriteri 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4 plotesojne dy grupet e punes per studimin e ekonomise pyjore kjo e mbeshtetur ne *Manualit te planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave*”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 sipas paragrafit D.1.1 Secili nga ekipet e punes se terrenit duhet te perbehet nga 2 specialiste profesioniste (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert ne punen e terrenit). Kjo eshte perberja minimale e 1 ekipi qe do punoje ne terren.

2.3.5 Për stafin kryesor të angazhuar, operatori duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimit që ka marrë përsipër të realizojë.

2.3.6.Operatori ekonomik duhet të disponoj **çertifikatat ISO** sipas formatit te miratuar ne shqip dhe anglisht ku ne *fushen e certifikimit te jene parashikuar punimet e Zhvillimit te Planeve te Menaxhimit ne Pyje* si me poshte:

-Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalent e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
-Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001:2015** ose ekuivalent e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.7 Makineri dhe pajisje.

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Lloji i mjetit/pajisjes	Sasia	Disponimi
Mjet transporti për personelin tip fuoristrade 4 x 4	2 copë	Pronësi/ose me qera
Aparat GPS	2 cope	Pronësi/ose me qera
Diameter mates	2 copë	Pronësi/ose me qera
Turjel per marrjen e kampioneve ne diameter	2 copë	Pronësi/ose me qera
Lazer meter (dstance meter)	2 copë	Pronësi/ose me qera
Pjerresi mates+lartesi mates(Hypsometer) apo ekuivalent.	2 copë	Pronësi/ose me qera
Kompjuter dhe printera per punime zyre	2 copë	Pronësi/ose me qera
Busulla	2 copë	Pronësi/ose me qera
Meter shirit deri ne 20m	2 copë	Pronësi/ose me qera
Peshore per peshimin e barit	2 cope	Pronësi/ose me qera

a)Për pajisjet e mesiperme , të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, ose nje dokument tjeter qe verteton blerjen e pajisjeve, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e transportit tip fouristradë 4x4 janë të nevojshme për akses në parcela dhe zona me terren të vështirë, ku do zhvillohen matjet dhe grumbullimi i të dhënave. Pajisjet teknike si GPS, diameter mates, Turjel, Lazer meter, Busulla, Meter shirit, Hypsometer, janë instrumente bazë për matjen, grumbullimin e të dhënave në terren.

Kompjuter dhe printera nevojiten për përpunimin e të dhënave të terrenit dhe për punime në zyrë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e referencës me të gjithë elementet përbërës janë hartuar mbështetur në “Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019. Manuali dhe Termet e referencës përcaktojnë në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të të dhënave më pas në zyrë.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për subjektin që do të hartojë Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për këtë ekonomi pyjore /kullosore, bazuar në Manualin e lartëpërmendur dhe eksperimentat më të mira të deritanishme të ekspertëve lidhur me këtë fushë.

Përllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mabrështimit për këtë ekonomi pyjore është realizuar duke u referuar në VKM-në nr. 361, datë 12.05.2010 "Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik" si dhe në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit.

Specialistet e fushës, anëtarë të Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.118 date 24.02.2026, kanë rënë dakort për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Kaçinar, Bashkia Mirditë"**, me fond limit prej: **12 616 500** (Dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë pa Tvsh, lloji i procedurës: **E hapur, Shërbim.**

Specialistët e fushës kanë hartuar kërkesat për kualifikim lidhur me kapacitetin teknik (pika 4 e nenit 74 të Vkm-së nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar) Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJESIA E PROKURIMIT